


Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

05/2517/10-1262

26.09.2016

l. bertari.

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Arban Abrashi</i>	DATE DATUM DATE	26.09.2016
NGA / OD / FROM	<i>Deputetja Blerta Deliu Kodra</i> 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:


I nderuar Ministër

Duke pas parasysh numrin e të papunëve në Kosovë dhe kërkesat e shumta për t'u punësuar sidomos në vendet e Evropës nga të rinjtë e shtetiti tonë ju si ministri keni për detyrë që të angazhoheni në lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare apo ndërshtetërore për punësimin sezonal të qytetarëve në lëmi të caktuara.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

A ka Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndonjë marrëveshje me ndonjë shtet për punë sezonale të ndonjë lëmie të caktuar?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

05/2518/ko-1263

26.09.2016

e hartuar.

PËR / ZA / TO	<i>Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale z.Arban Abrashi</i>	DATE DATUM DATE	26.09.2016
NGA / OD / FROM	<i>Deputetja Blerta Deliu Kodra</i> <i>BD Kodra</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:


I nderuar Ministër

Krijimi i komisionit qeveritar për verifikimin e viktimave të dhunës seksuale edhe në ditën e sotme mbetet një çështje e papërfunduar

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Pse është vonuar krijimi i këtij komisioni dhe deri ku kanë shku punët për formimin e këtij komisioni?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

05/25/19/10-1264

26.09.2016

PËR/ZA/TO	<i>Ministrin e Financave z. Avdullah Hoti</i>	DATE DATUM DATE	26.09.2016
NGA/OD/FROM	<i>Deputeti Bekim Haxhiu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Qeveria e Kosovës dhe Doganat e Kosovës kanë bërë marrëveshje bashkpunimi me Qeverinë e Shqipërisë dhe Doganat e Shqipërisë për tregeti të lirë dhe lehtësira doganore. Ka pas disa paraqitje publike dhe proklamime sa i përket marrëveshjeve me Republikën e Shqipërisë. Por, përkundër kësaj qytetarët tanë të cilët kalojnë tranzit nëpër Republikën e Shqipërisë me mall apo automjet që kanë për ta zhdoganuar në Republikën e Kosovës detyrohen të paguajn për kalim tranzit nëpër Shqipëri, shpedicionin dhe skanerin. Qytetarët tanë paguajn për skaner në dogana 5 Euro për mallë nën vlerën 1000 Euro dhe 22 Euro për mall në vlerë mbi 1000Euro. Shërbim të cilin e paguajn por nuk e marrin. Në fakt është vetëm si gjobë. Gjithashtu me pagesën e transitit dhe shpedicionit qytetarëve tanë iu vështirësohet kalimin nëpër Shqipëri në raport me vendet tjera fqinje kur destinacioni i mallit për zhdoganim është Kosova.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

A mund të na sqaroni përse duhet qytetarët tanë të paguajn transitin, shpedicionin dhe skanerin në Shqipëri, kur malli ka për destinacion Kosovën?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

e bartaq.
05/2520/10.1265

26.09.2016

PËR/ZA/TO	<i>Ministrin e Shëndetësisë z.Imet Rrahanin</i>	DATE DATUM DATE	26.09.2016
NGA/OD/FROM	<i>Deputeti Bekim Haxhiu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:


I nderuar Ministës

Gjendja në shëndetësinë e Kosovës vazhdon të jetë e rënduar, përveq mungesave të furnizimeve me barna tani janë paraqitur edhe mungesat e furnizimit me ushqim. Deri më tani ka pas vështirësi në furnizim me barna por falë ndërhyrjes tuaj tani spitalet kanë vështirësi që pacientët të i furnizojnë me ushqim.

PYETJE :

I nderuari Ministër:

Pasi që përmes projektbuxhetit të vitit 2016 SHSKUK-së ia keni marrë buxhetin dhe e keni kaluar në AFSH. Sa e ndini vetën përgjegjës për mungesat e krijuara në furnizimin me barna dhe ushqim për pacientë?



e bantur.

05/2523/Bo-1268

26.09.2016

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

PËR / ZA / TO	z. Blerand Stavileci Ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik	DATE DATUM DATE	26/09/2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Abdyl Ymeri, Deputet		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		


Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA:

Kosova në të kaluaren. por edhe tani vazhdon të ballafaqohet me mungesë të energjisë elektrike, Pas analizave të shumta të bëra nga ekspertë të fushës së energjetikës, kemi një përfundim së Kosovës i duhet ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, si domosdoshmeri për sigurimin e furnizimit me energji, e cila mundëson zhvillimin ekonomik të vendit. Projekti për termocentralin “Kosova e Re” është një nga projektet më të përfolura në dhjetëvjetëshin e fundit, i cili në periudha të caktuara ka pësuar disa ndryshime në projekt dhe në emër. Por në fund, Komiteti Drejtues i Projektit të Termocentralit, ka përzgjedhur kompanin nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Contour Global”, për ndërtimin e termocentralit.

PYETJE PARLAMENTARE:

z. Ministër, deri ku ka shkuar dinamika e këtij procesi dhe kur pritet të filloj ndërtimi i Termocentralit “Kosova e Re”.



e barten.

05/2526/10-127A
27.04.2016

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Skënder Hyseni Ministër i Punëve të Brendshme	DATE DATUM DATE	27.09.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Aida Dërguti <i>Aida Dërguti</i> Deputete e Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! Nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA: Nga mbledhja e parë e përbashkët midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, në 11 janar 2014 dhe marrëveshjeve të dakorduara, qeveria në Tiranë mori vendim me datë 7 maj 2014 për *Përfundimin nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare.*

Në mars 2015, pra 1 vit më vonë Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale njoftonte se u firmosën tri marrëveshje bashkëpunimi me Republikën e Shqipërisë. Nënshkrimi u bë në atë kohë nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Erion Veliaj dhe homologu i tij Arban Abrashi. "Më konkretisht u arrit marrëveshja për heqjen e lejeve të punës dhe liberalizimin e tregut të punës mes dy vendeve, nga Gjirokastra deri në Mitrovicë".

Shqipëria i ka hequr lejet e punës për shtetasit nga Kosova, ndërsa Kosova u zotua ta bëjë këtë shumë shpejt për shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Në pyetjen e shtruar Ministrin të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në seancën e kaluar ai u përgjigj se për këtë duhet të pyesim Ministrin e Punëve të Brendshme dhe se Ministria që drejton ka lobuar për këtë ndryshim si dhe e ka kryer punën por Ministria e Punëve të Brendshme ende nuk e ka realizuar pjesën e saj.

Tani jemi 2 vite e 5 muaj nga mbledhja e dy qeverive dhe 1 vit e gjysmë nga nënshkrimi i marrëveshjes për lejet e punës.

PYETJA PARLAMENTARE: Z. Ministër pse nuk po e zbatoni marrëveshjen e nënshkruar nga Kryeministri dhe Ministrat e Republikës së Shqipërisë me homologët e tyre në Qeverinë e Kosovës, duke mos i hequr ende lejet e punës për shtetasit e Shqipërisë dhe shqiptarët që jetojnë në shtete të tjera të rajonit ?



e barter.

05/2530/100/1275
27.09.2016

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR/ZA/TO	<i>Imet Rrahmani</i> <i>Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	27.09.2016
		Reference	
NGA/OD/FROM	Shukrije Bytyqi ,Deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës <i>[Signature]</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Grupi Parlamentar NISMA për Kosovën		

Në bazë të Rregullës 45.2 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Kosovës bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës


Çështja: Asnjëherë, Ministria e Shëndetësisë, prej asnjërit minister, prej kur është bërë kërkesa e parë për licencimin e drejtimit Kimi organike me Biokimi në vitin 2009, e as sot ministri aktual z. Imet Rrahmani, nuk kanë treguar gadishmëri që t'i përmbushin kërkesat sipas standardeve europiane për sigurimin e cilësisë në laboratorët e analizave biokimike të gjakut në institucionet shëndetësore, duke angazhuar staf profesional si: Kimist, Biokimist.

Si është e mundur që, tërë kohën flitet për reforma në shëndetësi, në njëren anë, a në realitet, qytetarët për çdo ditë kërkojnë të marrin rezultate nga laboratorët e analizave të gjakut në Shkup dhe Tiranë.

Edhe në shtetet e Bashkimit Europian është e lejume puna profesionale e një Kimisti dhe Biokimisti në laboratorin e analizave të gjakut.

Prej Janar 2016 ne kemi vazhduar me kërkesat tona, por si duket gjithmonë po hasim në vesh të shurdhur.

Pyetja: Ministër edhe sa kohë duhet me prit për me marrë një përgjigje?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

e bantur.

05/2532/164277

27.09.2016

PËR / ZA / TO	Z. Arban Abrashi, Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale	DATE DATUM DATE	27.09.2016
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE! Kuvendi i Republikës së Kosovës		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje për përgjigje me gojë		

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Në Republikën e Kosovës, në tetë muajt e fundit (pra nga shkurti deri në shtator 2016) në vendin e tyre të punës, nga lëndimet e marra, si pasojë e mungesës të kushteve të sigurisë teknike dhe të mbrojtjes së detyrueshme kanë humbur jetën 10 punëtorë. Numri sigurisht që dyshohet të jetë më i lartë sepse kompanitë sigurohen që rastet mos të arrijnë deri të mjetet e informimit.

Këtij numri çdo muaj i shtohen punëtorë të sëmurë rëndë ose nga rrugët respiratorë, ose nga forma të rënda tumorale. Të gjitha si pasojë e ekspozimit në kushte të rënda të punës. Ditët e fundit u bë publik dhe arrestimi i Koordinatorit të Inspektoriatit të Punës për rajonin e Prishtinës i cili kishte pranuar 10 mijë euro.

Ne deputetët ende nuk kemi para vetes në Kuvend, qoftë edhe një projekt për ndryshim plotësim të masave më të ashpra ligjore, edhe sa i takon kompanive, edhe sa i takon penalteteve dhe përzgjedhjes se inspektorëve të punës.

Pyetja Parlamentare: Çfarë ka bërë Ministria e Punës dhe mirëqenies sociale për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punëtorëve në Kosovë? Sa raste abuzimi nga punëdhënësit janë dorëzuar në organet ligjzbatuese nga Inspektorët e punës?